



**BESA E SHENJTË E BESIMIT
DHE BINDJES!**



**“NUK ËSHTË I LINDUR
DHE NUK KA LINDUR
KUSH PREJ TIJ”**



**LEBBEJKE!
– MADHËSHTIA E QABES**

Viti 17 - Nr. 8 (198),
Gusht, 2019

Botim i Myftinisë Shkodër


UDHA ISLAME

*E përmuajshme
Informative - Fetare
Kulturore - Edukative*

LEBBEJKE! MADHËSHTIA E QABES

Rrugëtimi i haxhilerëve drejt Qabes ka qenë dhe mbetet histori. Një histori sa qiellore aq dhe njerëzore. Ka përqafime e lot në sy, fjalë zemre e fjalë mbarësie, përshëndetje e urime zemre, përmallime e rrëfime, pritje e gëzime... etj. etj.

Në nisjen e këtij rrugëtimi, haxhilerët kanë motive të ndryshme dhe adhurime. Në këtë rrugëtim të moçëm, shekull pas shekulli, dekadë pas dekadë e vit pas viti, si atëhere edhe sot, një diçka nuk ka ndryshuar: Ai është AMANETI, i cili është shprehur në forma të ndryshme por thelbi dhe përmbajtja nuk kanë ndryshuar. Është AMANETI!..





Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

Të gjitha falënderimet e plota dhe madhështia absolute i takojnë vetëm All-llahut të Madhëruar, Zotit të vetëm të gjithësisë, i Cili na udhëzoi në Islam dhe na bëri pjesë të më të merit ymme!

Salavatet dhe selamet më të përzmërtia ia dërgojmë sot, në këtë ditë dhe në çdo moment të jetës sonë, Ma të Mirit e Ma të Dashtunit Pejgamber, zotërisë së bijve të Ademit, Hz. Muhammedit (a.s.), që u dërgua mëshirë për tanësinë!

TË DASHUR BESIMTARË,

Në këtë hytbe të parafundit të muajit të fundit të vitit 1440 h., në prag të përkujtimit të ngjarjes më të rëndësishme në jetën e Resulull-llahut (a.s.), që ndryshoi rrjedhat e historisë së njerëzimit; Hixhretit, më lejoni të ndaj me ju një detaj nga udhëtimi i grupit të haxhilerëve shkopdranë të para ca ditëve, nga Meka drejt Medines së Ndriçuar.

Është një udhëtim i shumëpritur, ku haxhilerët largohen të përmalluar nga Meka e begatuar me Qaben e Madhnueshme, drejt Medines së begatuar me Resulull-llahun (a.s.), për jetën e të cilit betohet vetë Zoti i gjithësisë në Kur'anin Famëlartë.

Ndërkohë që kishin ngelur edhe 75 km pa hyrë në Medinen e Ndriçuar, pas këshillimit me murshidin e grupit tonë, u ngrita të flas. Ça të flisja e si të flisja? Më dukej se fjalët më ishin lidhur në grykë dhe nuk dilnin. Është një moment kur njeriu është i mbushur me emocionet e udhëtimit dhe destinacioni final është i gdhendur në mendje e zemër, të cilat, nga ana e tyre, pulsojnë mall dhe padurim deri në mbërritjen e shumëpritur.

Gjatë gjithë kohës, në hatër më vinin dy momente kulminante në jetën e Resulull-llahut (a.s.) në Medinë. Dy

BESA E SHENJTË E BESIMIT DHE BINDJES!

momente, që janë fiksuar në Kur'anin Famëlartë dhe që për korrektësi të amanetit, poi vendos para duarve tuaja, sot në këtë hytbe të parë, pas kthimit nga Haxhi i këtij viti.

Ajeti i parë, është i dhjeti i sures El-Fet'h, ku All-llahu i Madhëruar dëshmon se: "Ata që të japin besën ty, në të vërtetë ata i zotohen All-llahut, dora e All-llahut është mbi duart e tyre. E kush e thyen (zotimin), ai e thyen vetëm në dëm të vetin, e kush e zbaton atë që i është zotuar All-llahut, Ai do t'i japë atij shpërblim të madh."¹

Dhe, ejani të ndalemi pak tek kuptimet e këtij ajeti, kontekstet e shpalljes së tij dhe mirësinë që ka për ne deri në ditën e kijametit.

VËLLEZËR TË SHTRENJTË,

Gjithsecili prej nesh ka nevojë që herë pas here ta ripërtërijë besimin e tij, ashtu siç porositi edhe Resulull-llahu (a.s.): "Ripërtërijeni besimin tuaj" – I thanë: Si ta ripërtërijmë besimin tonë, o i Dërguar i All-llahut? Tha: "Shtojeni shprehjen: La ilahe il-lall-llah".²

Nga këtu, kemi nevojë të shohim në vetvete cilësinë e marrëdhënies me fenë tonë, gatishmërinë për t'iu përgjigjur All-llahut dhe të dërguarit të Tij, forcën për të ndryshuar secili në vetvete, që më pas të mos shohim këto modele dekadente që e marrin vendin dhe shoqërinë, pasuritë dhe mirësitë, me të cilat na ka begatuar All-llahu, drejt greminës dhe mjerimit, pasigurisë dhe korrupsionit, krimi dhe shkatërrimit, që janë të dënuara në fenë e All-llahut dhe në traditat e Hz. Muhammedit (a.s.)!

Në tefsirin e ajetit të lartpërmendur, Imam Maturidiu, shkruan se: "Krejt komentatorët, a pjesa më e madhe e tyre, janë të mendimit se kjo besëlidhje e përmendur në këtë ajet, ka ndodhur në Hudejbije, atë ditë kur sahabët i dhanë besën Resulull-llahut (a.s.) që të mos i kthejnë shpinën, nëse do të përballëshin me armikun e tyre! Ma'kil ibn Jesari (r.a.) thotë: Ditën e besëlidhjes së pemës, teksa Resulull-llahu i mernte besën njerëzve, unë ia largoja një degë nga degët e saj, nga koka e tij. Atë ditë

ishim 1400 burra..."³

Ndërsa Imam Fekhruddin Razi, shpjegon se kuptimi i ajetit: "dora e All-llahut", "përmban dy kuptime: që do të thotë se dora, e përmendur në dy vende, ose ka dy kuptime të ndryshme, ose një kuptim të vetëm në të dy vendet. Dhe, kjo ka dy interpretime. I pari: "dora e All-llahut" me kuptimin: Mirësia e All-llahut qëndron mbi veprimin e tyre fisnik... I dyti: "dora e All-llahut është mbi duart e tyre", pra: Përkrahja e Tij ndaj tyre është më e fortë dhe më e lartë se përkrahja e tyre ndaj tij (pejgamberit). Ndërsa, nëse themi se "dora" këtu ka dy kuptime të ndryshme, themi: Në hak të All-llahut, ka kuptimet e mbrojtjes

Vetëm duke ecur në rrugën e një marrëdhënie të fortë e korrekte me frymën e besëlidhjes së shenjtë, para duarve të Mësuesit të Madh, mund të shpresojmë në ndreqjen e të sotmes sonë dhe të ardhmes së fëmijëve tanë!

dhe, në hak të atyre që japin besën, ka kuptimet e gjymtyrës."⁴

Disa ajete në vijim, All-llahu i Madhëruar dëshmon sërish: "Vërtet, All-llahu është i kënaqur me besimtarët kur ata nën hijen e asaj peme të zotoheshin ty dhe Ai e dinte se ç'kishin zemrat e tyre, andaj u dhuroi qetësimin dhe së shpejti i shpërbleu me një fitore".⁵

"Pra, i dhuroi qetësinë, rehatinë e nefsit dhe i forcoi zemrat e tyre"⁶, siç e shpjegon edhe Imam Alusi në tefsirin e tij.

Prandaj, të dashurit e mi, sa herë që udhëtojmë drejt Resulull-llahut (a.s.), a

3. Imam Ebu Mensur El-Muturidi (v. 333 h.), Te'vilatu Ehli-Sunneh, botimi i parë, 2005, Bejrut, Darul-kutubil-ilmiye, vëll. i 9-të, f. 298.

4. Imam Fekhruddin Er-Razi (544-604 h.), Et-Tefsirul-Kebir, botimi i parë, 1990, Bejrut, Darul-kutubil-ilmiye, vëll. i 28-të, f. 75-76.

5. Kur'ani, El-Fet'h: 18.

6. Imam Shihabuddin Es-Sejjid Mahmud El-Alusi (v. 1270 h.), Rruhul-Meani, botimi i 4-t, 2014, Bejrut, Darul-kutubil-ilmiye, vëll. i 13-të, f. 261.

sa herë biem salavate për zotninë e tij, sa herë na kujtohet një hadith, a sa herë lexojmë për jetën e tij (a.s.), ia vlen të ulemi pak në qetësi dhe t'i japim besën Resulull-llahut (a.s.) për të hequr dorë nga një gjynah, për të mos përdorur më një ndalesë, për të shtuar edhe një adhurim, për të korrigjuar vetveten, për të bërë mirë e për të ndryshuar drejt më të mirës, ashtu si i takon një besimtari aktiv e të gjallë!

"Besë e dhënë Resulull-llahut (a.s.) në vetvete është besë e dhënë All-llahut të Madhëruar, i cili thotë: "në të vërtetë ata i zotohen All-llahut". Sepse feja është parim hyjnor dhe sistem i shpallur nga qielli në tokë, drejt të cilit në shkojmë. Në të nuk ka njeërz, por është i ndërtuar mbi parimet. E vërteta është se, sa më tepër që madhërohen parimet, zvogëlohen njerëzit dhe sa më tepër që zvogëlohen parimet, madhërohen njerëzit! Besimtari i singertë i ka dhënë (dhe i jep) besën All-llahut për bindje dhe sakrificë, për këtë, qëllimi i tij është i madh..."⁷

Ndërsa ajeti i dytë është i dymbëdhjeti i sures El-Mumtahine, ku Zoti i gjithësisë na sjell në vëmendje edhe besën që gratë besimtare i dhanë Resulull-llahut (a.s.): "O Pejgamber, kur të vijnë besimtarët që të të japin besën se: nuk do t'i shoqërojnë asnjë send All-llahut; se nuk do të vjedhin; se nuk do të bëjnë imoralitet; se nuk do t'i mbysin fëmijët e tyre; se nuk do të gënjejnë me ndonjë shpifje për (fëmijën e huaj që kanë marrë) se është i tyre; dhe se nuk do të të kundërshtojnë në atë që i urdhëron, atëherë prano zotimin e tyre dhe lute All-llahun t'i falë ato, se All-llahu është mëkatfalës dhe mëshirues."⁸

Pra, ftesa është e hapur për besimtarët dhe besimtarët, pa përjashtim!

Prandaj pyete veten: A je gati t'ia japësh besën Resulull-llahut (a.s.) dhe vetë All-llahut të Madhëruar për të ecur në rrugën e virtyteve dhe ndërgjegjes së ushqyer me pastërtinë e besimit?

Vetëm duke ecur në rrugën e një marrëdhënie të fortë e korrekte me frymën e besëlidhjes së shenjtë, para duarve të Mësuesit të Madh, mund të shpresojmë në ndreqjen e të sotmes sonë dhe të ardhmes së fëmijëve tanë!

(Hytbeja e mbajtur në xhaminë e Parrucës, ditën e xhuma, më 23 gusht 2019)

7. Dr. Muhammed Ratib En-Nabulsi, Tefsirun-Nabulsi, botimi i parë, 2016, Aman, Muessasetul-fursan, vëll. i 8-të, f. 524.

8. Kur'ani, El-Mumtahine: 12

SHOQËRIA SHQIPTARE NË KTHETRAT E AFETARIZMIT

Po risjell në vëmendjen tuaj një material që pata publikuar para ca kohësh. E shoh me vend në këtë katrahurë e anarshi ku është katandisur vendi.

Afetarizmi si shkatërrim individual e shoqëror, tek Hafiz Ali Kraja...

Më tërheq jashtë mase personaliteti i Hoxhës së nderuar shkopdran, Hafiz Ali Kraja (1898-1974). Shkrimet e tij periodike, sidomos në revistën "Zani i Naltë", janë objekt studimi për teologët e rinj dhe përtej tyre.

Sot, dua të ndalem tek kritika që i bën Hafiz Ali Kraja, afetarizmit, si një dëm i madh individual dhe rrezik ekstrem për shoqërinë.

Duke parë degradimin e realiteteve shqiptare, si pasojë e politikave afetare dhe islamofobe, si dhe deformimin e shumë koncepteve mbi fenë, moralin, demokracinë, lirinë, drejtësinë, paqen, harmoninë, trashëgiminë shpirtërore e kulturore etj, mendoj se fjalët e Hoxhës së nderuar, vazhdojnë të jenë akoma në koherencë me këto zhvillime për kombin dhe të ardhmen e tij!

Kjo do të thotë se detyra e muslimanëve shqiptarë karshi fesë dhe kombit të tyre është shumë më e madhe, sesa izolimi në jetën e xhamisë, fetarizmi i fjetur e i rëndomtë dhe partishmëria parazite ndaj erërave të ndryshme, që fryjnë sa andej-kënde, pa pasur paraprakisht një bosht të mirëfilltë strategjik dhe një shtyllë kurriore identitare!

"Besimi mban rregullimin dhe harmoninë e shoqërisë njerëzore. Shoqëria paraqet një trup, pjesëtarët e të cilit janë në harmoni me atë vend ku respektohen rregullat e moralit. Në pikëpamje morale, kjo harmoni e ka burimin në përbashkësinë e ndjenjave, si fetare ashtu edhe të tjera, të personave që përbëjnë shoqërinë. Po ta heqim Besimin prej mjedisit, kjo harmoni shuhet vetvetiu.

Afetarizmi është një rrezik si për shoqëri ashtu për pjesëtarët e saj që janë fetarë. Besimi, pra, është gurra e cila ia bën të këndshme jetën njeriut dhe i jep atij shpresa për lumturi. Ai që është larg kësaj gurre është fatmjerë dhe sikur t'i zotërojnë të gjitha mjetet materiale që i duhen në këtë jetë; ai

është i mjerë se i mungojnë ndjenjat e larta morale të cilat do ta bënin atë të lumtur.

Afetarizmi nuk është vetëm një mjet shkatërrues për veten dhe për shoqërinë, por njëherazi edhe për familjen. Vetëm interesi e lidh afetarin me familje.

Se Besimi është një nevojë për shoqërinë njerëzore dhe se njerëzit

"Besimi mban rregullimin dhe harmoninë e shoqërisë njerëzore. Shoqëria paraqet një trup, pjesëtarët e të cilit janë në harmoni me atë vend ku respektohen rregullat e moralit. Në pikëpamje morale, kjo harmoni e ka burimin në përbashkësinë e ndjenjave, si fetare ashtu edhe të tjera, të personave që përbëjnë shoqërinë. Po ta heqim Besimin prej mjedisit, kjo harmoni shuhet vetvetiu."

pa Besim nuk mund të jetojnë në formë të shoqërisë, u tregua edhe në manifestimet tragjikomike në kohën e revolucionit të madh francez...

Me të vërtetë, atë ditë që të fiket ideja e Besimit, po atë ditë njerëzimi është plandosur në humnerë të shkatërrimit." – (Hafiz Ali Kraja, "A duhet Feja, a e pengon bashkimin kombëtar", ribotimi i KMSH-së, Tiranë, 2010, f. 18-21. Botimi i parë, Shkodër, 1934.)

Dialogu dhe hapja me tjetrin, mund të ishte një mundësi e mirë e ballafaqimit të mendimeve, ideve, besimeve e vokacioneve të ndryshme shpirtërore e kulturore, në rrugën e qartësimit të interesave të ndershme e të shëndosha kombëtare!

Imam Muhamed B. Sytari

Myfti i Zonës Shkodër

Shkodër, më 20 gusht 2019



Xhahid Bushati, shkruar

Qabja, veçanërisht, për myslimanët por edhe më gjerë, është një ëndërr. Një ëndërr e bukur dhe sublime. Një ditë, kur kjo ëndërr realizohet, teksa kthehesh për në vendlindja, vetiu shpirti të thotë: ‘Qabja, përsëri, mbetet ëndërr’. Shpirti, përsëri, të thotë: “Ah, sikur të shkoja prapë!” Kështu, Qabja mbetet ëndërr e përjetshme edhe kur e realizon atë, mbase, edhe më shumë se një herë.

Rrugëtimi i haxhilerëve drejt Qabes ka qenë dhe mbetet histori. Një histori sa qiellore aq dhe njerëzore. Ka përqaftime e lot në sy, fjalë zemre e fjalë mbarësie, përshëndetje e urime zemre, përmallime e rrëfime, pritje e gëzime... etj. etj.

Në nisjen e këtij rrugëtimi, haxhilerët kanë motive të ndryshme dhe adhurime. Në këtë rrugëtim të moçëm, shekull pas shekulli, dekadë pas dekadë e vit pas viti, si atëhere edhe sot, një diçka nuk ka ndryshuar: Ai është AMANETI, i cili është shprehur në forma të ndryshme por thelbi dhe përmbajtja nuk kanë ndryshuar. Është AMANETI!..

Të gjitha këto m’u kujtuan se edhe unë fatlumsisht, pak vite më parë e bëra një Umre në Qabe.

Të gjitha këto m’u kujtuan teksa po lexoja librin e dashur të titulluar “Lebbejke” të autorit Imam Muhamed Sytari. Qabja më dilte e gjallë dhe më fliste me madhështinë e saj. Tek unë, gjatë komunikimit me këtë vend të shenjtë, më shfaqeshin: përmallimi, dashuria, adhurimi, Profeti, ritet... Tek ky libër, përmes rrëfimeve të autorit, gjeta të shpalosur përjetësinë dhe madhështinë e Qabes.

1.

Po të shikojmë e shqyrtojmë me vëmendje krijimtarinë e deritanishme të nxjerrë në qarkullim, përmes viteve, të autorit Imam Muhamed B. Sytari, është e pamundur të mos i gruposh por edhe të

LEBBEJKE! – MADHËSHTIA E QABES


Shënime për librin “Lebbejke..!”

të autorit Imam Muhamed B. Sytari, AIITC, Tiranë, 2018.

Meditim... (Në vend të një parathënieje)

gjesht disa elemente të përbashkëta, si: konceptet e ndërtimit të veprës, lëndën e afruar, gjininë a zhanrin me të cilin operon, dëshmitë, tradita, memoaristika, bashkëkohësia (aktualiteti), etj., etj. Dhe këto grupime janë: a) veprat e përkthyer, b) opinione, c) vështrime në fushën e gazetarisë islame, d) monografi, e) bibliografi, f) eseistikë, g) komente, etj.

Të gjitha këto grupime e pse jo edhe nëngrupime përfshijnë hapësira të gjera të dijes islame. Për këtë bibliotekë librash të çmuara, në jetën e tij të deritanishme, autorit Sytari i është dashur të studiojë e të lëcisë biblioteka e biblioteka librash



Teksa po lexoja librin e dashur të titulluar “Lebbejke” të autorit Imam Muhamed Sytari. Qabja më dilte e gjallë dhe më fliste me madhështinë e saj. Tek unë, gjatë komunikimit me këtë vend të shenjtë, më shfaqeshin: përmallimi, dashuria, adhurimi, Profeti, ritet... Tek ky libër, përmes rrëfimeve të autorit, gjeta të shpalosur përjetësinë dhe madhështinë e Qabes.

kryesisht në gjuhë të huaj. Kështu, në këto rrugë, ka vendosur ta gdhendë e ta dimensionojë personalitetin e tij. I thashë të gjitha këto, për të kuptuar se sa i gjerë dhe i shumanshëm është portreti i Misionarit të vërtetë i Thirrjes Islame.

Mendoj se i njoh veprat e Imam Sytarit. Kam shkruar për disa syresh. Gjatë leximit dhe rileximit të kësaj biblioteke, të teksteve të ofruara, gjithnjë kam menduar, si dhe veprat ma kanë ofruar një mendim të tillë, se duhet lexuar domosdoshmërisht libri islam, marrëdhënia me të duhet të jetë edhe më e ngushtë. Më lejoni të citoj një fragment nga shkrimi i studiuesit Metin Izeti: “Falënderimi është përgjigje që pason pas pranimit të së mirës, por, siç duket edhe prej më lart, është edhe pararendëse e saj dhe e lidhur ngushtë me të mirën. Në këtë kontekst na paraqitet edhe një aspekt tjetër relevant antropologjik i falënderimit i cili është në lidhje me lumturinë autentike. Falënderimi dhe lumturia janë të lidhura ngushtë midis vetes, ashtu që lumturia autentike është e pamundur pa falënderimin. Kjo është kështu për shkak se lumturia e njeriut nuk është në përpjestim me numrin e të mirave që i pranon, por me vlerësimin falënderues të asaj që e ka pranuar. Si rrjedhojë e këtij falënderimi është pjesa përbërëse e lumturisë që e ndiejmë nga gjërat e pranuar nga jashtë. E pranuar nga jashtë përmes falënderimit shndërrohet në kapital të brendshëm personal.” Këtu mbaron citimi dhe po vazhdoj argumentin tim: Feja myslimane është fe e vërtetë. Për vërtetin a vërtetët kemi më shumë se kurrë nevojë sot, kur realitetet tona kanë ngjyra të turbullta, të trishtuara e shpesh tragjike. Leximi i këtij libri bëhet më imperativ, sepse familja myslimane, fëmijët e moshat rradhë-rradhë, vlerat e vërteta të jetës së tyre do t’i gjejnë edhe në librin islam. Sepse misionin e leximit të librit islam nuk po e bën si duhet dhe sa duhet shkolla, nuk po e bën si duhet dhe duhet as mësuesi. Unë kam besuar dhe besoj që modelet më të shkëlqyera të kësaj rruge fisnike të këtij edukimi janë imamët. Është detyrë e tyre. Edhe në

1. Izeti, Metin: Pasqyra estetike e traditës perenniale, shkrimi: Falënderimi si e bukur dhe shprehje e së bukurës, shtator 2017, f. 191.

këtë detyrë ata do të kenë falënderimet e fëmijëve, familjarëve, vendit ku jeton, Atdeut. Do të kenë falënderimet e Zotit.

2.

Në udhëshkrimin e autorit Sytari, vepra “Lebbejke..!” shënon numrin 22. Një bibliotekë që pasuron dijen islame dhe më gjerë! Një bibliotekë që gjithësekush do ta kishte lakmi. Një bibliotekë, ku si autor, i ka shokët e rrallë. Një bibliotekë që rrezaton mesazhe të rëndësishme për jetën dhe vërtetët që duhet t’i mishërojë dhe t’i njëjtësojë njeriu në raport me veten, familjen, komshinjtë, komunitetin dhe realitetin që jeton.

Nga kjo lëndë e bollshme diturore nuk bën përjashtim edhe botimi më i ri “Lebbejke..! Në këtë botim të ri, profili i autorit Sytari, tashmë i formuar, vjen me një dimension të ri, që pa hezitim dëshiroj ta them, se autori ka hyrë me dinjitet në udhën e dijetarëve, që realisht i kemi të pakët. Për këtë autor-dijetar jemi fatlum! Lexojeni veprën e re “Lebbejke..!”, dhe do të më jepni të drejtë!

Gjatë shfletimit të çdo faqeje, emocionet dhe kujtimet ishin të pranishme dhe shëtisnin me mua. Kujtime të shtrenjta dhe të paharruara, të cilët më falnin çaste të bukura sa jetike aq dhe poetike. Shumëçka më kujtonin... Më përmallonin, e pse jo dhe pse ta fsheh, edhe më falnin lot. Ca vite më parë, siç e thashë edhe më lart, pata fatin të bëja UMRE-në në Mekën e shenjtë dhe të bekuar. E si të mos t’i kujtosh ato ditë e net të qëndrimit tim atje, që kishin ngjyrën dhe hapësirën e hyjnisë, dhe vetëm në ëndërr mund t’i shihje dhe t’i jetoje ato, ku dita ishte mrekulli dhe gjumi nuk ekzistonte si gjumë. Doja të shihja e të dija çdo gjë, doja të vizatoja me sytë e mi çdo gjë, doja çdo gjë ta strehoja në shpirtin tim si gurë të çmueshëm, e t’i merrja me vete në Shkodrën time. Që kur të mbërrija në tokën dhe qiellin e Vendlindjes sime, të nisja bisedën me magjijtë e Mekës, bisedë që vazhdon edhe sot e kësaj dite për çmueshmërinë e qëndrimit tim në atë vend të çmueshëm. Motivet janë të shumta... Ja, që për mua ato ditë e net, që nuk janë asnjëherë të largëta, nuk plaken kurrë në shpirtin tim. Në shumë vite ato ishin ëndërr, tani janë e përgjithmonë realitet i të jetuarit me këtë realitet. Për ato ditë të paharruara, autori Sytari shkroi një libër, që po ta lexoni me kujdes, do të ndjeni se dashuria, malli, afria nuk kanë dimension. Vetë libri, po të shprehemi metaforikisht ishte një “MEKË”

Gjatë shfletimit të çdo faqeje, emocionet dhe kujtimet ishin të pranishme dhe shëtisnin me mua. Kujtime të shtrenjta dhe të paharruara, të cilët më falnin çaste të bukura sa jetike aq dhe poetike. Shumëçka më kujtonin... Më përmallonin, e pse jo dhe pse ta fsheh, edhe më falnin lot.

dashurie me selame pafund, apo siç thotë autori: “E dua pa kushte këtë vend..!”. Teksa po lexoja librin “Lebbejke..!” m’u kujtuan ato ditë-net të papërsëritshme, këndova me zë shpirti ca vargje nga poezia “Qabja e Madhnueshme” me autor babain tim, Hysniun, m’u kujtua libri “Dëshmitar në sahar... (2013), dhe meditova për t’i risjellë sadopak ato çaste që e bënë jetën time të lumtur, me një lumturi të papërsëritshme. “Lebbejke..!” – e përsërita në Meke, e përsëris gjatë leximit të librit, do ta përsëris edhe pas leximit të këtij libri-dijetar që mbart një titull nme një përfaqësim të një simbolike universale. Me një universalitet të gjithëkohshëm, në shumë plane, me shtresa e nënshtesa paraqitur si retrospektivë e kohësi, shfaqet Madhështorja e Madhështive – Meka, apo siç thotë autori Sytari: “Veshur me të bardha, të gjithë rendin drejt teje, në kërkim të një drite, që jetës i jep kuptime udhëzimi... Zoti të bëri shenjë, zemrat drejt saj i ftoi, në kërkimet tona të udhëzuara drejt një Dashnie, që jetës kuptim i jep... Me sy e zemër nga Qabja e Madhnueshme, krejt thirrën me bindje: “Lebbejke!”.”

3.

Teksti i librit “Lebbejke..!” e përfaqëson autorin, kësaj here, si pelegrin. Në udhëtimin e tij të disa muajve më parë në Mekën e bekuar dhe të shumëëndërruar, mbresat janë aq të mëdha e të pashlyeshme, sa ai vendosi t’i hedhë në faqe libri. Kështu, faqe pas faqeje, mori fytyrë libri, dhe është ky që keni në dorë. Brenda tij është i përshkruar imtësisht udhëtimi

mbrësëlënës me gjithë pasuritë e tij të vyera, dhe poetika e përshkrimeve buron nga thellësia e zemrës së autorit. Në këtë rrugëtim pasqyrohen takime të ndryshme, biseda të zhvilluara, njohje e rinjohje, shkëmbime kulturash e psikologjish, njohje realitetesh e realitete të reja, dialogë e argumente, ligjërimi, modele referimi e rrëfim ngjarjesh e historish... etj., etj. Të gjitha këto ‘të qëndisura’ me flade kujtimesh që fryjnë e fryjnë parreshtur...

Libri “Lebbejke..!” na paraqitet i konceptuar dhe strukturuar sipas këtij imazhi real: 1. I paraprin një fjalorth shpjegues termash, 2. Parathanje nga Prof. Sami Repishti, 3. Lënda e librit e paraqitur në 28 pjesë, 4. Bibliografi e librave të botuar nga ana e autorit.

Fillimisht po ndalem e shpjegoj, përse është i nevojshëm Fjalorthi?

Fjalët e paraqitura në të janë orientalizma. Janë fjalë të moçme e të vyera që kanë lindur, kanë marrë të drejtën e përdorimit dhe të komunikimit në kohëra e realitete të caktuara historike, si domosdoshmëri. Nuk janë vjetëruar. Nuk kanë humbur. Jetojnë edhe sot e kësaj dite. Kanë vlera universale përdorimi, semantikën e tyre mbartin funksione të patjetërsueshme, bazike, përligjin kuptimin e fjalës a të shprehjes, kanë ngarkesa emocionale dhe shpirtërore. Këto fjalë nuk mund të zëvendësohen a të largohen nga istikamet e tyre. Janë fjalë-çelësa, përdoren për karakterin njohës që u bëjnë dijeve të lexuesit, kuptimshmërisë dhe përdorimit me vend e të saktë gjatë komunikimit, zgjerojnë diapazonin tematik të dijeve fetare. Të gjitha së bashku i falin lexuesit dhe studiuesit thellësinë e njohjes së tekstit të librit, të çdo libri fetar, sigurisht kjo është e lidhur me problematikat që trajton libri në kohë e në hapësirë.

Tani po përmend disa fjalë-çelësa të tjerë, me kuptime të tjera, me ngarkesa të tjera emocionale dhe me vlera universale. Me to autori operon gjatë gjithë pjesëve të tekstit, operon me sukses e devocion, ku Drita e Mekes lëviz e shpërndahet gjithandej... I jep çdo faqeje të tekstit pjesë nga mrekullia e saj e dëshmia e saj. Këto fjalë-çelësa, në gjykimin tim, u ngajnë kodeve, dhe autori i shënjon kështu: sy, zemër, Qabja e Madhnueshme, vlera, urtësia, mirësia, haxhi, shqiptarët, Meka, qytet i madhëruar, Haxhi Vehbi Dibra, Hafiz Ibrahim Repishti, shtëpi, Pejgamberi (a.s.), I lumi unë, sureja e dialogut, I dashur mik, hurmë, besim, horizont, lebbejke, Isra, Hakim, Iman, Jasin, Muzeu i paqes, vetvetja, shehidë,

dita e kijametit, parfum, sexhade, xhami, faleminderit, vend. Të gjitha këto kode që përmenda më lart, flasin për një gjeografi nocionesh shpirtërore, vendesh e personazhesh; të cilat janë akte jete e besimi. Të gjitha këto kode që përmenda më lart flasin edhe për një dimension tjetër, për një gjeografi hapësinore të pamatë, ku realja bëhet ireale, ku irealja bëhet reale. E kur zë fill marrëdhënia e komunikimit, njerëzorja dhe hyjnorja janë të pranishme me madhësinë e tyre.

Për arsye analize e mesazhi, kam zgjedhur një kod, që titullohet: “Të dashur të zemrës: Isra, Hakim, Iman dhe Jasin”.² Është një letër e shkruar në ditën e Kurban Bajramit. Autori, Muhamed B. Sytari është në Mekë. Si dukuri e parë na shfaqet largësinë e prindit. Si dukuri e dytë na shfaqet largësinë e mallit. Si dukuri e tretë na shfaqen porosinë për bijtë e tij. Si dukuri e katërt, pra, për t'i zvogëluar ato largësi, ka përdor frazën-titull: “Të dashur të zemrës!”

Si fillim e si kredo të kësaj letrë, ka përzgjedhur ca vargje të një poezie të autorit Mehmet Akif Ersoj, dhe janë nga libri i tij “Fletët”. Citoj: “Bajrami, një kohë qetësie e prehjeje pas një viti përpjekjes, / Për zemrën e rënë në pesimizëm, shpresë dhe jetë është!”³

Çfarë përmban letra e autorit Muhamed B. Sytari? Po përmend disa karakteristika: *Komunikimi mbart aromë prindërore., *Çdo frazë e rresht ka shkëlqimin e dritës., *Modeli i komunikimit me fëmijë, një gur i çmuar., *Letra ka vlerën e një amaneti., *Letra ka vlerën e një testament në vazhdimësi.

Tani po vazhdoj analizën, duke veçuar disa paragrafë:

- Mirësia e prindit, takti, shqetësimi, dhimbja, si cilësi njerëzore. Të gjitha këto formulojnë përjetësinë e komunikimit. Citoj: “..., asnjëherë nuk ju kemi larguar nga mendja dhe zemra. Jemi lutur për ju, si të ishit aty me ne!”
- Raportet prind-fëmijë, për të mos humbur njëri-tjetrin. Citoj: “... duat t’ju them se ju duam shumë dhe na mungoni. Kështu e kanë prindërit; kështu rritemi bashkë me ju nëpërmjet ndodhive dhe ngjarjeve të ndryshme, udhëtimeve dhe largimeve të përkohëshme që kanë një domethënie në jetën tonë, sidomos ato që lidhen me shpirtin e besimit dhe thirrjen e Zotit në jetën tonë!”
- Raportet prind-fëmijë, si vazhdimësi e

2. Sytari, Bardhyl Muhamed: Lebbecke...!, shkrimi: Të dashur të zemrës: Isra, Hakim, Iman dhe Jasin!, f. 118-119, AIITC, Tiranë, 2018.

3. Ersoj, Akif Mehmet: Fletët, botimi i dytë, f. 145, Shkup, 2009.

Kështu, faqe pas faqeje, mori fytyrë libri, dhe është ky që keni në dorë. Brenda tij është i përshkruar imtësisht udhëtimi mbrësëlënës me gjithë pasuritë e tij të vyera, dhe poetika e përshkrimeve buron nga thellësia e zemrës së autorit. Në këtë rrugëtim pasqyrohen takime të ndryshme, biseda të zhvilluara, njohje e rinjohje, shkëmbime kulturash e psikologjish, njohje realitetesh e realitete të reja, dialogë e argumente, ligjërime, modele referimi e rrëfim ngjarjesh e historish... etj., etj.

njëri-tjetrit. Citoj: “Ne dëshirojmë të dini se, për ne jeni si drita e synit dhe dëshirojmë për ju do mirësi e bekim nga Zoti, të cilit i lutemi vazhdimisht për ju; të sotmen dhe të ardhmen tuaj..!”

• Amaneti që e bën prindin krenar. Citoj: “Me zemër, Baba i juaj, që ndjehet krenar me ju!”

4. Si çdo libër, edhe “Lebbejke..!” ka veçoritë e tij, veçori që e bëjnë të përveçëm. Të përveçmet, që janë konstatuar gjatë studimit tim të librit në fjalë, janë:

* Historia është e pranishme dhe lëviz në shumëforshmërinë e saj në kohë, vend dhe hapësira, me shenja vitesh e datash që s’duhen harruar, me porosi, me urtësi dijetarësh e filozofësh, njerëzish e personazhesh, me ngjarje e rrëfime.

* Personazhet mbartin histori dhe drama. Ata rrëfejnë... copëza historish vetiake dhe familjare e më gjerë, amanete të kthyer në testament që kanë udhëtuar e udhëtojnë edhe sot e kësaj dite si vlera e si aktualitet. Personazhet për vlerat që mbartin janë modele sa vetiake aq dhe shoqërore, në mos populllore; modele që duhen përqafuar.

* Ngjarjet, bindjet, devocionet, dija, qëndresa, papërkulshmëria, mos-harresa, filozofitë etj., gjejnë pasqyrim në

gërshetime vitesh, kohërash dhe shekujsh.

* Kronika e paraqitur dhe e rrëfyer ka besnikëri kohore, fytyrë reale dhe të besueshme.

* Në përcjelljen e ideve dhe të mesazheve, forca e argumentit, e shoqëruar me një biobibliografi të pasur e deri një farë mase shterruese që i është qasur autori si studiues, ka vlera të patjetërsueshme dhe bindëse, të një udhëtimi të drejtë e plot virtyte.

* Elementet poetike që shfaqen në secilin kapitull, janë fllade mirësie brenda hapësirës së librit, të cilat janë të lidhura me stilin ligjërimesor të autorit, stil që është i kristalizuar e që të fal kënaqësi estetike, kjo “e përkthyer” në kategori estetike përmban: të bukurën e të madhërishtmen.

* Kujtimet si pjesë e të rrëfyerit të lëndës u ngjajnë përmendoreve, atyre përmendoreve që kanë diturinë si rrezeshpërndarje.

*Marrëdhënia e autorit si Thirrës Islam me këtë qytet të shenjtë, ka vlerë pasaporte deri në frymën e fundit e përtej saj. Në një nga shkrimet e këtij libri, autori thotë: “Ka njëzet vjet që më ka thirrë Qabja... I lumi unë!”

Që të gjitha këto veçori që përmenda më lart, sigurisht ka edhe të tjera; si vatër e ngrohtë dashurie, mikpritëse e si substancë i përbashkon kjo shprehësi e autorit, ku zemra dhe shpirti i tij flasin njëherësh: “Të gjithë e duam këtë vend! Të gjithëve na bën për vete. Këtu ndryshojnë oraret e jetës. Dita dhe nata, nën komandën e ezanit dhe namazeve, tavafit dhe lutjes, marrin tjetër dimension.

Njerëzit në këtë vend ndjehen të plotësuar, të ndriçuar, të mbushur me besim dhe shpresë, të gatshëm për të dhënë më të mirën e tyre në çdo ditë të jetuar me bekim e mëshirë nga Zoti Mëshirëbërës!

Janë më bamirës, më altruistë, më bashkëpunues në të mira, më ndihmëtarë, më të qeshur, më të gatshëm për të thënë fjalën e mirë, më pranë njerëzve në nevojë, më të ruajtur!

Këtu, të gjithëve u kalon në zemër ndjesia e bukur e shprehjes së bashkëmoshatarit tim shqiptar: “I lumi unë..!” dhe, pa asnjë dyshim, ajo mbetet dëshmi sinqeriteti dhe arritjeje në besim!”⁴

Shkodër, gusht 2019

4. B. Sytari, Muhamed: Lebbecke...!, AIITC, Tiranë, 2018; Ka njëzet vjet që më ka thirrë Qabja... I lumi unë!, f. 88.

KUJTIME

LIRIMI NGA BURG U DHE DËSHPËRIMI I MOSTAKIMIT ME H. SHEUQET BORIÇIN

Më 12 tetor 1965, Hafiz Ali Kraja lirohet nga burg, pasi ishte dënua për pikëpamjet e tij politike kundër ideologjisë ateiste komuniste.

Pasi u lirua nga burg kishte shprehur dëshirën të takohej me mikun e tij të vjetër, Hafiz Sheuqet Boriçi, një dijetar i njohur i kohës. Nëpërmjet z. Fejzi Boriçit, nip i Hafizit, i çon fjalë mikut të tij, që ta vizitonte, vizitë e cila nuk u realizua asnjëherë, për shkakë, jashtë vullnetit të tyre...

Pas dy muajve, Hafiz Ali Kraja lajmërohet se miku i tij ndërroi jetë. U mërzi aq shumë, saqë faqet iu mbushën me lot nga dëshpërimi i mostakimit me hoxhën e ditur shkodran. Në momentin e faljes së xhenazes, te xhamia e Parrucës, Hafiz Sabri Bushati, më i vjetër se ai në moshë, i drejtohet: “Hafiz, falja xhenazen, se ai të ka dashur shumë...”, por Hafizi nuk mund ta bënte këtë nga emocioni...

Atëherë, Hafiz Sabriu e mori për dore dhe e afroi pranë vetes, duke ia falur xhenazen të dy pranë njëri-tjetrit... Në përfundim të xhenazes, Hafiz Ali Kraja, mbajti një fjalë prekëse, ku tregoi vlerat e Hafiz Sheuqet Boriçit, për të cilin thoshte se e ka ditur persishten si askush në Shqipëri...

SHOQËRIA E H. ALI KRAJËS

Hafiz Ali Kraja, kishte miqësi të madhe me H. Sheuqet Boriçin, me H. Sabri Bushatin, me H. Musa Dërgutin, (të cilin e kishte takuar në burg), me H. Muhamed Bekteshin, me Sheuqet Mukën, me Hamdi Bushatin, (që e kishte si vëlla), etj.

Sidomos, pas daljes nga burg, Hamdi begu vinte pothuajse çdo ditë dhe rrinte me orë të tëra me babën, në një dhomë më vete. Kuptohet se për çfarë flisnin me njëri-tjetrin...

Edhe një fakt interesant, në vitin 1966, ishte Ramazani i parë i tij pas daljes nga burg. Axha im, që ishte besimtar dhe frekuentues i xhamive, e lajmëron se në xhaminë e Rusit ka dalur një hoxhë i ri, shumë i aftë. Bëhej fjalë për H. Sabri Koçin. U përgatit dhe u nisëm drejt xhamisë. Unë, e shoqëroja edhe për efekt sigurie, pasi sapo kishte dalë nga burg dhe ishin kohë të vështira. Në xhami, i bënë një pritje të mirë e vlerësuese. E dëgjoi vasin e hoxhës së ri, u falëm dhe erdhëm në shtëpi.

Gjatë diskutimit për mbresat e tij, pas kthimit nga xhamia, pat thënë: “Njeri orator, me një prezencë të dukshme, i shkathët dhe punëtor... Po të çohet jashtë për një shkollë të lartë teologjike, bëhet i mirë...”

... Natyrshëm, saherë sjellim në vëmendjen tonë kujtimet dhe gjurmët e të shkuarve tanë të ditur e të urtë, marrim dhe përfitojmë nga shembulli dhe qytetaria, me të cilën, ata ditën të ndërtojnë ura vëllazërie, diturie, zhvillimesh intelektuale, harmonie dhe vlerash qytetare e kombëtare, që asnjëherë s’i mbulon pluhuri i harresës... All-llahu i Madhëruar i mëshiroftë me mëshirën e Tij dhe i shpërbleftë për jetën, që ia kushtuan All-llahut dhe fesë së Tij!

Imam Muhamed B. Sytari

Shkodër, më 29 gusht 2019



IRAKU ISLAM

Profeti i Islamit, Muhammedi, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, kishte lajmëruar qysh më përpara se do të çlirohej Jemeni, Shami edhe Iraku.

Profeti i Islamit, Muhammedi, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, kishte lajmëruar qysh më përpara se do të çlirohej Jemeni, Shami edhe Iraku.^[1]

Dhe vërtetë këto vende hynë në dritën e Islamit njëri pas tjetrit, ashtu siç kishte lajmëruar Profeti i nderuar. Jemeni iu bashkëngjit kalifatit islam që në kohën kur Profeti Muhammed, alejhi selam, ishte gjallë, pastaj Shami dhe Iraku u çliruan në kohën e Ebu Bekrit dhe të Omerit, Allahu qoftë i kënaqur prej tyre.

I dërguari i Allahut u tregon një ditë shokëve të tij: “Pashë në ëndërr sikur po nxirrja ujë me kovë nga një pus i hapur, dhe erdhi Ebu Bekri e nxori një apo dy kova...nxori pak... Pastaj erdhi Omeri e filloi të nxirrte ujë për t’u dhënë njerëzve të pinë, e kova që kishte në duar u kthye në një kovë të madhe; nuk kam parë zotëri ndër njerëz të veprojë aq fuqishëm si ai; nxori ujë derisa ua shoi etjen njerëzve, dhe pastaj ata u shpërndanë për në vendet e tyre.”^[2]

Këto fjalë të Profetit të ndritur, sipas dijetarëve, tregojnë për zgjerimet islame dhe ndikimin e këtyre dy sahabeve të nderuar në to. Ebu Bekri (r.a), qëndroi një periudhë të shkurtës si kalif i muslimanëve, prandaj nuk arriti të bëjë shumë në këtë drejtim. Ndërsa Omerit (r.a), iu dha mundësia të qëndronte një periudhë më të gjatë në këtë detyrë, dhe puna e tij u bekua me suksese të njëpasnjëshme, duke arritur që nën drejtimin e tij Islami të përhapej fuqishëm dhe me shpejtësi, në Afrikë, në Sham, dhe deri në portat e Persisë së lashtë.

Pas largimit nga kjo jetë e të Dërguarit të Allahut, paqja dhe mëshira qofshin mbi të, Prijës i besimtarëve u caktua Ebu Bekri. Koha e tij si prijës i muslimanëve qe e shkurtër, vetëm dy vjet. Gjatë kësaj periudhe ai u përball me shumë vështirësi, por i kapërceu të gjitha me sukses. Gjatë kësaj kohe muslimanët kërcënoheshin nga persët që ishin të vendosur në Irak, në kufi më shtetin e ri të kalifatit islam. Ebu Bekri

zgjodhi Halid Ibnul-Velidin në krye të ushtrisë muslimane për në betejat për zbrapsjen e forcave persiane. Halid Ibnul-Velidi arriti që brenda disa muajsh të merrte më shumë se gjysmën e Irakut. Pastaj, siç e kemi përmendur edhe më parë, Halidit iu kërkua që bashkë me ushtarët e tij më të zgjedhur, të nisej drejt Shamit për në Jermuk, duke e lënë Muthenne ibnul-Harith zëvendës të tij mbi ushtrinë muslimane që gjendej në Irak. Në këtë kohë persët filluan të ushtrojnë presion mbi Muthennen, dhe ky i dërgoi fjalë

ndaluan dhe e këshilluan të zgjidhte një komandant shumë të aftë, pikërisht Sead ibn Ebi Vekas-in, në krye të ushtrisë. Dhe vërtetë, Seadi arriti të kornte fitoren e Kadisijes, atë fitore kyçe, siç e kemi përmendur edhe më përpara, e cila do të ishte dera për të depërtuar më thellë në Irak. Ata iu drejtuan Medain-it, kryeqyteti i atëhershëm i Irakut, dhe gjetën se mbreti Sasanid persian ishte arratisur nga Pallati i Bardhë, që kishte qenë selia e tij.

Pastaj, rrethana të tjera e detyruan

Qyteti i Bagdadit i ndërtuar nga kalifi abasit, Ebu Xhafer El-Mensur



kalifit Ebu Bekër që t’i dërgonte forca shtesë. Përgjigjja iu vonua, prandaj ai vendosi të shkonte vetë ta takonte Ebu Bekrin. Kur Muthenne mbërriti në Medinë, e gjeti kalifin të sëmurë, dhe nuk arriti t’i fliste. Pasi Ebu Bekri e mori vesh lajmin e ardhjes së Muthennes, e kuptoi se bëhej fjalë për diçka urgjente, prandaj fjalët e tij të fundit thënë Omer Ibnul-Hattabit, ishte porosia e tij që të përgatiste një ushtri të madhe, e ta dërgonte me Muthennen në Irak, me qëllim që të pengonin agresionin persian.

Ebu Bekri, Allahu qoftë i kënaqur prej tij, ndërroi jetë, dhe kalifi i muslimanëve u zgjodh Omer ibnul-Hattabi.

Ushtria e muslimanëve në Irak po përballlej me forca të shumta, dhe Omeri mendoj të shkonte vetë personalisht në krye të kësaj ushtrie, por sahabet e

kalifin Omer ibnul-Hattab t’i vazhdonte luftimet kundër persianëve, derisa i mundi plotësisht në betejën e Nehavandit, betejë e cila përfundoi me fitoren e madhe të muslimanëve. Historianët muslimanë fitoren në këtë betejë e quajnë fitorja e fitoreve, sepse me këtë rast persianët u copëtuan e u shpërndanë, dhe shteti i tyre u mposht plotësisht.

Pas marrjes së Irakut, Omer ibnul-Hattabi e kishte urdhëruar Sead ibn Ebi Vekasin të ndërtonte një qytet për muslimanët, sepse ata ishin të lodhur nga atmosfera e Medainit ku kishin qëndruar deri atëherë, qëkur kishin marrë Irakun; ose, ndoshta Omeri kishte frikë se mos zakonet dhe luksi i jetesës në kryeqytet do të mbizotëronin tek muslimanët. Në vitin 16 H, Seadi ndërtoi qytetin e Kufes, i cili do të ishte

si një bazë e ushtrisë islame në Irak.

Afërsisht aso kohe (viti 14 H), Utbeh ibn Gazvan kishte ndërtuar qytetin e Basrës në zonën e Eblës, në Irak, zonë të cilën e kishte marrë më parë nga persianët. Omeri e kishte urdhëruar edhe Utben më parë që të ndërtonte një qytet afër portit të Eblës, qytet i cili do të shërbente si bazë e forcave muslimane, në mbrojtje të vendeve islame nga sulmet e mundshme të persianëve.

Kështu, Kufe dhe Basra u bënë dy bazat kryesore të ushtrive islame, të cilat që aty do të përparonin drejt lindjes. Zgjerimet islame në kohën e Omerit, Allahu qoftë i kënaqur me të, u karakterizuan nga qëndrueshmëria dhe stabiliteti.^[3]

Më vonë, kur kalif i muslimanëve u zgjodh Ali ibn Ebi Talib, ky e bëri Kufen kryeqytet të shtetit Islam. Me kalimin e kohës, Kufja zuri një vend të rëndësishëm në fushat e politikës dhe të luftës. Ky qytet dëshmoi përplasje dhe ngjarje politike të rëndësishme të asaj kohe. Atje ra dëshmor kalifi i katërt i Islamit, Ali ibn Ebi Talib, dhe diku aty afër pati ndodhur edhe ngjarja e Qerbelasë.

Pas rënies dëshmor të Ali ibn Ebi Talib, atë do ta zëvendësonte djali i tij Hasani, i cili qëndroi në atë post, po në Kufe të Irakut, gjashtë apo tetë muaj (ka transmetime të ndryshme), por që u tërhoq nga ai pozicion me vullnetin e tij, duke e dorëzuar tek Muavije ibn Ebi Sufjan, me qëllim ruajtjen e unitetit mes muslimanëve, dhe stabilitetin e kalifatit islam.

Kohë më përpara, Profeti Muhammed, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, kishte thënë për Hasanin (r.a): “Ky djali im është zotëri; ndoshta përmes tij, Allahu do të bëjë pajtim mes dy grupeve të mëdha të muslimanëve.”^[4]... dhe ashtu ndodhi vërtetë.

Pasi Hasani (r.a) hoqi dorë nga posti si kalif i muslimanëve, dhe njohu autoritetin e Muavijes, e kalifati islam hyri nën sundimin e Dinastisë Emevite.

Kryeqyteti i shtetit Islam tani u transferua nga Kufja, për në Damask, në Sham.

Gjatë periudhës Emevite, Iraku u karakterizua nga paqëndrueshmëria politike dhe rebelimet ndaj pushtetit.

Profeti (alejhi selam) që më parë kishte paralajmëruar se muslimanët do të drejtoheshin nga Kalifët e Drejtë për

një periudhë tridhjetë vjeçare, pastaj do të sundonin mbretëritë. Kështu, pas tridhjetë vjetësh, në krye të kalifatit islam u vu Dinastia Emevite, e cila sundoi deri në vitin 750 e.j.

Pas Emevitëve, në vitin 750, pushtetin e mori Dinastia Abasite. Këta ishin pasardhës të Abas ibn Abdul-Muttalib, xhaxhai i të Dërguarit të Allahut, paqja dhe mëshira qofshin mbi të!

Me ardhjen në pushtet, abasitët e transferuan kryeqytetin e shtetit Islam, nga Damasku, në Kufe, pastaj në Enbar, përpara se të vendosnin të ndërtonin një qytet të ri, Bagdadin, për të qenë kryeqytet i tyre.

NDËRTIMI I BAGDADIT

Kalifi i dytë abasit, Ebu Xhafer El-Mensur, dëshiroi të ndërtonte një kryeqytet të ri të shtetit të tij, larg nga qytetet që rebeloheshin shpesh ndaj kalifëve të tyre, si Kufja dhe Basra. Ai synoi të zgjidhte një vend me pozitë të mirë gjeografikë e me klimë të moderuar, dhe zgjodhi Bagdadin, në bregun e lumit Tigër (Dexhle, ar.).

Kalifi El-Mensur, e vuri me dorën e tij gurin e parë të themelit për ndërtimin e qyteti të ri, në vitin 762 e.j. (145 H). Ai thirri inxhinierë të mëdhenj për të mbikëqyrur ndërtimin e qytetit, dhe gjithashtu solli atje një numër të madh ndërtuesish dhe mjeshtërish. Ata punuan me përkushtim të madh, derisa përfunduan nga puna, në vitin 766 (149 H). Pas përfundimit të punimeve, El-Mensuri i transferoi në qytetin e ri të Bagdadit familjen dhe gjithë shoqëruetit e tij, si edhe zyrat e shtetit. Që nga ai moment, Bagdadi u bë kryeqyteti i shtetit Abasid. El-Mensuri, qytetin e ri e quajti gjithashtu edhe “Darus-Selam - Qyteti i Paqes”, emër i marrë nga një prej emrave të Xhenetit, ose ndoshta iu referua Lumit Tigër (Dexhle) pranë të cilit u ndërtua qyteti, lum i cili është quajtur edhe si “Lumi i Paqes”.

Dizenjimi i qytetit ishte një mrekulli e planifikimit urban, dhe u quajti “projekti më i madh ndërtimor në botën islame”. Al-Mensur kuptoi se vendndodhja në bregun e Tigrit, do të siguronte një metropol aktiv në paqe, dhe një kështjellë të fortë në luftë. Qyteti u ndërtua në formë rrethore. Muret e jashtme u fortifikuan dhe për siguri shtesë, ato u rrethuan nga një kanal i thellë uji. Këtij qyteti të rrethuar me mur, iu bënë katër porta, të gjitha

në të njëjtën distancë nga qendra dhe të lidhura me qendrën e qytetit me rrugë të drejtpërdrejta, duke u mundësuar kështu rojave për të pikasur pa vështirësi çdo problem brenda apo jashtë qytetit. U ndërtua gjithashtu edhe një rrjet i mirë-planifikuar për ujin e pijshëm si edhe për ujërat e zeza. Në mes të qytetit ishte qendra mbretërore, me Xhaminë e Madhe, dhe me Pallatin Mbretëror me kupolën e mrekullueshme prej dyzet metrash të lartë, të veshur me smerald, e cila dallohej nga milje larg.

Meqë Bagdadi u ndërtua në rrugën tregtare që lidhte Azinë qendrore me viset lindore, ai u bë një qendër tregtare me tregje që ofrojnë mallra jo vetëm nga të gjitha pjesët e botës muslimane, por edhe nga Evropa dhe vendet e tjera të largëta, si India dhe Kina.

Qyteti i Bagdadit lulëzoi për tre shekuj me radhë, dhe u bë qyteti më i madh dhe më i bukur në botë, veçanërisht gjatë sundimit të kalifit të tretë abasid, Harun Reshidit, emri i të cilit gjendet gjithmonë i bashkangjitur me emrin e këtij qyteti në tregimet e “Njëmijë e një netëve”, apo edhe në pjesën tjetër të letërsisë botërore.

Historianët janë të një mendimi se kalifi abasid, Harun Reshidi (vd. 192 H / 809 e.j) është ai i cili vuri bërthamën e parë të “Shtëpisë së Urtësisë” (Bejtul-Hikme) në Bagdad, ku themeloi atë që njihet si “Depoja e Urtësisë”. Kjo “Depo e Urtësisë”, ishte një bibliotekë që përmbante disa libra të filozofisë greke, të cilat Reshidi i kishte marrë me vete nga vendet romake bizantine, gjatë njëres prej fushatave të tij mbi qytetet e Azisë së Vogël, si: Ankaraja dhe Amurija. Kalifi ia kishte besuar përkthimin e këtyre librave nga greqishtja në arabisht, dijetarit të krishterë nestorian: Jahja ibn Mase’ije. Kjo “Depo e Urtësisë”, përfshinte gjithashtu edhe disa libra të trashëgimisë persiane, të cilët Reshidi ia besoi Fadl ibn Nubaht-it, t’i përkthente nga persishtja në arabisht.^[5]

Vazhdon në numrin e ardhshëm...

Përgatiti:

Msc. **Arta Ujkaj**, teologe

1. Buhariu: 1751.
2. Buhariu: 3479.
3. Tarih Et-Taberij
4. Buhariu: 2704.
5. <https://islamstory.com/ar>

HAXHI, UDHËTIMI I JETËS! GUSHT 2019

Medina e Ndriçuar është tokë historie dhe udhëzimi. Kudo ku hedh vështrimet, ka një gjurmë. Është gjurmë që të frymëzon. Janë gjurmë që të zgjojnë.

Kudo gjen një shkak për të kuptuar madhështinë e kësaj feje të begatë islame! Kudo ka gjurmë mirësie, që dëshmojnë për sakrificë të pashembullt të ndërtuar mbi vullnete burrash, për të cilët dëshmon vetë Kur'ani Famëlartë.

Kudo ndjen se e mira, krejt e mira, është derdhur në këtë vend, duke e mbuluar me bujari e paqe, me pastërti e besim, që preket kudo e me këdo!.. "Ky vend e zbut inatin!", më tha sot, Haxhi Isaja, njëri prej burrave të urtë të grupit tonë, teksa po më fliste me pasion për mbresat e tij të fituara nga kjo vizitë e parë në Medinen e Ndriçuar. (E kujt nuk i vezullojnë sytë, kur flet për Medinen e zemrës?).

Mbrëmë vizituam kopështin e hurmave, ku 15 shekuj më parë, katragjyshërit e medinelive të sotëm, mirëpritën Resulull-llahun (a.s.), duke i hapur zemrat, para dyerve të shtëpive të tyre. Ndonëse ishte natë, mbretëronte një qetësi e jashtëzakonshme,

Pashë nga afër bunarin e vjetër, ku kishte pirë ujë i Dërguari i All-llahut (a.s.). Edhe unë piva nga ai ujë, shija e të cilit ndryshonte nga ajo e krejt burimeve, që kam shijuar në jetë. Të zotët e kopështit patën mirësinë të na jepnin edhe prej fruteve të axhvasë, hurmave të përmendur në hadithin e saktë, që dëshmon për vlerat e tij të mrekullueshme. Hurmat e ujitur nga burimi i Resulull-llahut (a.s.)...

Sot, rastësisht u prezantuam me një ensarit vendali. "Jam medineli, prej ensarëve, brez pas brezi... jam nip i Hz. Sa'd ibn Ebi Vekkasit... E njihni Hz. Sa'din?", tha, duke më vështruar në sy. Ia ktheva: "Hz. Sa'd ibn Ebi Vekkas (radijall-llahu anhu)... Lutu për mua!". Më vështroi me një shikim të fortë e paqësor, pastaj u lut, si dikush që e ka në gen bekimin e lutjes së trashëguar nga Gjyshi i madh, ndërsa unë thashë: Amin!.., me një kënaqësi të madhe në zemër, që u gdhend në murin e kujtimeve të Medines...

Medina e zemrës, Medina e jetës! Vendi, ku gjen strehë malli i zemrës, drita e syrit, qetësia e shpirtit, lutja e natës, vrulli i ditës... Medina..!

Imam Muhamed B. Sytari
Myfti i Zonës Shkodër
Medine, 18 gusht 2019





Dr. Mustafa Mahmud

“NUK ËSHTË I LINDUR DHE NUK KA LINDUR KUSH PREJ TIJ”

ka krijuar krijuesin? Kush e ka krijuar Allahun, për të Cilin na flisni? A nuk çojnë të njëjtat argumente tek kjo gjë dhe si pasojë e të njëjtit ligj shkak-pasojë? Cili është mendimi juaj, qofshi të nderuar, për këtë ngërç?

Ne i themi atij: Pyetja jote është boshe dhe nuk ka ngërç e as që ka nevojë, sepse ti e pranon se Allahu është Krijuesi, pastaj thua: Kush e krijoi Atë?! Atë e bën Krijues dhe krijesë në të njëjtën fjali dhe kjo është kontradiktore.

Ana tjetër e pyetjes tënde boshe, është se ti e përfytyron Krijuesin t'i nënshtrohet ligjeve të krijesave të Tij, ndërkohë që ligji shkak-pasojë është ligji jonë i bijve të kohës dhe vendit.

Allahu, i Cili e krijoi kohën dhe vendin, Ai domosdoshmërisht është mbi (jashtë) kohës dhe vendit, e as që vlen për ne ta përfytyrojmë Atë të lidhur (varur) nga koha dhe vendi, dhe as me ligjet e kohës dhe të vendit.

Allahu, është Ai i Cili e krijoi ligjin shkak-pasojë, kështu që nuk na lejohet ta përfytyrojmë Atë të nënshtrohet ndaj ligjit shkak-pasojë, të cilin e krijoi.

Ti, me këtë arsyetim të shtrembër, ke krahasuar kukullat, të cilat lëvizin me kurdisje (me zemrek) se, edhe ato përfytyrojnë njeriun, i cili i ka krijuar ato, patjetër edhe ai lëviz me kurdisje (zemrek). E, nëse asaj i themi, se ai lëviz vetvetiu, thotë: E pamundur, që diçka të lëvizë vetvetiu, sepse unë shoh, se në botën time, çdo gjë lëviz me kurdisje (zemrek).

Kështu je edhe ti, nuk e përfytyron se Allahu ekziston Vetvetiu, pa asnjë

ekzistues të Tij të mëparshëm, thjeshtë sepse ti sheh, se çdo gjë përreth teje ka nevojë për një ekzistues.

Ti je si ai, i cili mendon, se Allahu ka nevojë për parashutë për të zbritur tek njerëzit dhe ka nevojë për autobus të shpejtë për të shkuar tek profetët e Tij... i Lartmadhëruar, i pa të meta dhe i pastër është Ai (xh.sh) prej gjithë këtyre përshkrimeve.

Emanuel Kanti, filozofi gjerman, në librin e tij “Kritika e mendjes së pastër” ka arritur në përfundim, se mendja nuk mundet të perceptojë realitetin (të vërtetën, thelbin, esencën) e gjërave dhe se ajo është e aftë, me natyrën e saj, të perceptojë vetëm gjërat e pjesshme dhe të dukshme. Në të njëjtën kohë, ajo është e paafte të perceptojë thelbin (esencën, të vërtetën) e pastër, siç është ekzistenca hyjnore. Ne e njohim Allahun me shpirt (ndërgjegje) dhe jo me mendje... malli (dëshira e madhe) jonë për drejtësi është argumenti ynë për ekzistencën e të drejtës, ashtu siç etja jonë për ujë është argumenti ynë për ekzistencën e ujit.

Ndërsa, Aristoteli ka shkuar edhe më tej në zinxhirin e shkaqeve (shkak-pasojë), duke thënë: Karrigeja është prej druri, druri është nga pema, pema është nga fara, fara është nga bujku dhe është detyruar të thotë se kjo vazhdimësi e njëpasnjëshme pambarimisht në kohë, patjetër duhet të na çojë në fillimin e parë, në shkakun që nuk ka nevojë për shkak tjetër; shkaku i parë ose lëvizësi i parë, që nuk ka nevojë për dikën që e lëviz; krijues që nuk ka nevojë për krijues, e kjo është e njëjta gjë, që ne

themi për Allahun.

Ndërkohë, Ibn Arabiu, përgjigja e tij për këtë pyetje: “Pyetja, se kush e krijoi Krijuesin?”, është pyetje që nuk bëhet, vetëm se nga mendje jonormale. Sepse Allahu, Ai është argument i ekzistencës dhe nuk është e drejtë, që të marrim ekzistencën argument të Allahut, pikërisht ashtu siç themi, se drita është argument i ditës dhe e kundërta e argumentit, nëse themi se drita është argument i dritës.

Allahu, Ai është argument, i Cili nuk ka nevojë për asnjë argument, sepse Allahu është i Vërtetë, i qartë Vetvetiu. Ai është argument për çdo gjë. Allahu shfaqet në rregullin, në përpikmërinë, në bukurinë, në përsosjen.. në gjetet e pemës, në pendët e palloit, në krahët e fluturës, në aromën e trëndafilin, në këngën e bilbilit, në lidhjen e yjeve dhe planetëve, në këtë varg simfonik, i cili quhet univers.

Nëse themi, se e gjitha kjo ka ardhur rastësisht, do të ishim, si ai që thotë se flakja në ajër e shkronjave të shtypshkronjës, mund të çojë vetvetiu në bashkim në formën e një strofe të poezisë së Shekspirin, pa poet dhe pa autor!

Kur’ani na bën të panevojshëm për gjithë këto debate, me disa fjalë të pakta dhe tepër të goditura, ku thotë me qartësi të prerë dhe pa bërë filozofi: “Thuaj: Allahu është Një. Allahu nuk ka nevojë për asgjë. Nuk ka lindur dhe as është i lindur. Dhe, askush nuk është i barabartë me Të”. – (Kur’ani, El-Ikhlâs)

Miku ynë na pyet duke qeshur: Përse thoni, se Allahu është Një? Përse të mos ketë shumë zota, duke ndarë mes tyre detyra të ndryshme?

Do t’ia kthejmë përgjigjen me të njëjtën logjikë, me të cilën ai vetë e pohon, me dituri dhe jo me Kur’an.

Do t’i themi atij, se Krijuesi është Një, sepse universi është i ndërtuar nga një xeheror (lëndë e parë) e vetme dhe sipas një projekti të vetëm. Nga hidrogjeni janë formuar 92 elementët e tjerë të tabelës së Mendelejevit, me të njëjtën mënyrë, me “shkrirje” (fuzion) dhe çlirim energjie atomike, me të cilën janë të ndezura yjet dhe flakërojnë diejt në hapësirën e universit.

Gjithashtu edhe jeta, e tëra ka lindur prej përbërjeve të karbonit. “Të gjitha llojet e jetës shndërrohen në karbon me djegie” dhe sipas një projekti anatomik të njëjtë. Anatomia e bretkosës, lepurit, pëllumbit, krokodilit, gjirafës, balenës zbulojnë planin anatomik të njëjtë.

Sikur zotërat të ishin shumë, ata do kë kishin pasur kontradiktë me njëri-tjetrin, secili zot do të kishte poseduar atë që vetë ka krijuar dhe qiejt e toka do të ishin shkatërruar. Allahut i takon madhështia dhe krenaria, e këto cilësi nuk pranojnë bashkëpronësi.

Të njëjtat arterie, vena dhe dhoma të zemrës. Të njëjtat kocka (eshtra). Çdo kockë ka simetrikun e saj. Krahut tek pëllumbi është shpatulla (gjymtyra e parë) tek bretkosa, i njëjti kockë me një ndryshim të vogël. Qafa tek gjirafa, me gjithë gjatësinë e saj, gjejmë tek ajo të shtatë rruazat e njëjta, të cilat i gjejmë tek iriqi. Sistemi nervor, ai është i njëjti tek të gjithë, përbëhet prej trurit, shtyllëz kurrizore, receptorët e ndjeshmërisë dhe receptorët lëvizës (sinjalizues).

Edhe aparati tretës, përbëhet nga stomaku, zorra qorre, zorrët e holla dhe zorrët e trasha. Aparati riprollues, të njëjtat vezë, mitra, testikujt dhe kanalet e tyre. Aparati urinar, veshkat, uretëri, fshikëza e urinës. Pastaj, njësia anatomike tek të gjithë është qeliza. Ajo ndodhet tek bimët, ashtu siç ndodhet tek kafshët dhe tek njeriu me të njëjtat specifika, merr frymë, shumohet, vdes dhe lind në të njëjtën mënyrë.

E, çfarë habie ka pastaj të themi, se Krijuesi është Një? A nuk tregon për këtë metoda e njëjtë?

Përse të ketë më shumë se një të plotë? A ka ai mangësi që të ketë nevojë për dikë ta plotësojë? Ata që janë të mangët janë mori (të shumtë në numër).

Sikur zotërat të ishin shumë, ata do kë kishin pasur kontradiktë me njëri-tjetrin, secili zot do të kishte poseduar atë që vetë ka krijuar dhe qiejt e toka do të ishin shkatërruar. Allahut i takon madhështia dhe krenaria, e këto cilësi nuk pranojnë bashkëpronësi.

Miku ynë qesh me kuptimin e hyjniteti, siç po e kuptojmë dhe thotë se, a nuk është i habitshëm ky Zot, i Cili ndërhyr në çdo gjë të vogël dhe të madhe?! Ai i udhëzon kafshët, e frymëzon bletën të bëjë koshere në male, nuk bie asnjë gjethe, përveçse Ai e di për të; nuk del asnjë fryt prej

farës së saj, përveçse Ai e di numrin e tyre; asnjë femër nuk mbart dhe as nuk lind, përveçse Ai e di për të. Nëse një këmbë rrëshqet në një gropë, Ai është i Cili e rrëshqet; nëse një mizë bie në ushqim, Ai është i Cili e ka hedh aty. Nëse prishet telefoni dhe nuk punon, Ai është i Cili e ka shkaktuar defektin. Nëse ndalohet shiu dhe nuk bie, Ai është i Cili e ka ndaluar; e nëse bie me denduri, Ai është i Cili e lëshon në atë mënyrë. A, nuk po e zini Zotin tuaj me shumë gjëra të pavlera me këtë lloj kuptimi?!

Nuk e kuptoj, a është Zoti në vështrimin e pyetësit i meritueshëm për hyjnitet, nëse Ai e largon Vetën prej këtyre përgjegjësisë, merr leje dhe i sjell shpinën universit, të cilin e ka krijuar dhe e lë të shkatërrojë njëri-tjetrin!

A, është Zoti i merituar në vështrimin e tij, ai zot i pa angazhuar, i pavëmendshëm, nuk dëgjon, nuk sheh, nuk përgjigjet dhe nuk kujdeset për krijesat e Tij? Pastaj, ku e di pyetësi, se një çështje dosido e pavlerë, që nuk meriton të ndërhyjë Zoti, ndërsa një çështje tjetër është e rëndësishme dhe me vlerë të madhe?

Miza, e cila duket e pavlerë në vështrimin e pyetësit, që nuk i intereson në shikimin e tij, se a ka rënë në ushqim apo jo, kjo mizë mund të ndryshojë historinë me këtë rënie të pavlerë të saj. Ajo mund të përhapë kolerën tek një ushtri dhe betejën ta fitojë pala tjetër, duke ndryshuar pas kësaj tërë ekuilibrat historikë. A nuk e ka mbyt Aleksandrin e Madh një mushkonjë?

Gjërat elementare të pavlera mund të çojnë në përfundimet më të rëndësishme dhe, ndoshta gjërat elementare më të rëndësishme mund të çojnë në një përfundim kot. I Gjithdituri i të fshehtës (gajbit), Ai është i Cili e di vlerën e çdo sendi.

A po e konsideron veten pyetësi këshilltar ndaj Allahut, duke i përcaktuar Atij detyrat që duhet të bëjë? I pastër dhe i lartmadhëruar është Zoti ynë ndaj këtij përfytyrimi naiv.

Zoti i merituar për hyjnitet këtu është Zoti, i Cili ka përfshirë me dijen e Tij çdo gjë; nuk i shpëton Atij asnjë grimcë atomike në tokë dhe as në qiell. Zoti, që është Dëgjuesi, Përgjigjësi dhe Kujdestari i krijesave të Tij.

(Marrë nga libri:
DIALOG ME MIKUN TIM ATEIST)

Përktheu nga arabishtja
dhe përshtati në shqip:

Lavdrim Hamja

HAXHILERËT E SHKODRËS DREJT VENDEVE TË SHENJTA

Paraditën e së enjtes, më 1 gusht 2019, në një atmosferë të begatë, në shoqërinë e tekbiereve nga minaret e xhamisë së Parrucës dhe besimtarëve të shumtë që kishin dalë për t'i përshëndetur, u nisën drejt vendeve të shenjta haxhilerët shkodranë të këtij viti.

Përpara mediave të pranishme, Myftiu i Shkodrës, Imam



Muhamed B. Sytari, uroi besimtarët që udhëtojnë për të kryer ritualet e Haxhit të sivjetshëm, duke e konsideruar këtë udhëtim si një bekim të madh për Shkodrën dhe mbarë Shqipërinë.

I pranishëm në këtë event ishte edhe Myftiu i Malësisë së Madhe, H. Edmir Smajlaj, imamë të xhamive të qytetit e fshatit, familjarë e dashamirë.

MYFTIU I DREJTOHET HAXHILERËVE ME KËSHILLA NË PRAG TË AREFATIT

Në vazhden e ligjëratave të dobishme nga imamë, teologë e myftilerë, që gjenden sivjet në grupin e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, ditën e xhuma, më 9 gusht 2019, pas namazit të akshamit, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari iu drejtua haxhilerëve shqiptarë të grumbulluar në çadrat e Minasë, me një këshillë në prag të Ditës së Arefatit.

Fillimisht Myftiu uroi haxhilerët shqiptarë për mirësinë e madhe, me të cilën Zoti i gjithësisë i ka përzgjedhur këtë vit në mesin e miliarda njerëzve në mbarë botën, për të dëshmuar adhurimet e ditëve të Haxhit në vendin më të mirë, në kohën më të begatë, në shoqërinë më të përzgjedhur.

Në ligjëratën e tij, Myftiu foli mbi rëndësinë e duasë në ditën e Arefatit, si dhe edukatën e saj në shembullin e pejgamberëve të shumtë, për duanë e të cilëve dëshmojnë ajete të shumta nga



Kur'ani Famëlartë.

Myftiu nxiti prindërit, që të falin e të bekojnë fëmijët e tyre në këtë ditë, të lutën për ta e të kërkojnë nga All-llahu i Madhëruar më të mirën për fëmijët e familjen e tyre, të bindur në përgjigjen e Tij (xh.sh.).

Myftiu tha se besimtari nuk duhet

XHAMIA E “DY VAJZAVE” SHTROHET ME TAPET TË RI

Ditën e xhuma paradite, më 2 gusht 2019 është bërë e mundur shtrimi i tapetit të ri të xhamisë së “Dy Vajzave”. Besimtarët frekuentues të kësaj xhamie, të cilët iu përgjigjen thirrjes së imamit të saj, teologut Lavdrim Hamja, do të kenë mundësinë të falen në kushte më komode, ku përveç gëzimit të shtrimit të xhamisë me tapet të ri, ata i gëzohen edhe bamirësisë së tyre.



Tapeti i ri me një dizajn të bukur dhe cilësi të mirë, do të zbkurojë më tepër këtë xhami bashkëkohore, që është e kompletuar me të gjitha kushtet e nevojshme, me ngrohje dhe ftohje, si dhe me klasa e ambiente të përshtatshme.

Myftinia Shkodër falënderon të gjithë ata besimtarë, të cilët kontribuuan për këtë bamirësi të xhamisë së “Dy Vajzave” duke lutur All-llahun e Madhëruar, që t'i dhurojë secilit mirësi e begati, dhe Zoti i Madhëruar i shtoftë shembujt e tillë të bamirësisë dhe përkujdesjes ndaj xhamive të All-llahut (xh.sh).

të ngurrojë të kërkojë nga All-llahu për zgjidhjen e asaj që ia trazon zemrën, për kapërcimin e halleve e vështirësive, për besimin e mirëqenien, sikurse duhet të kërkojë falje, i bindur në pranimin e lutjes dhe përfshirjen e tij në mëshirën hyjnore.

Ai u lut që muslimanët të ndjejnë madhështinë e asaj që janë, të jetojnë me dinjitet e krenari, larg padrejtësisë, por duke mos toleruar injorimin e tyre, nëpërkëmbjen e izolimin në shoqëri e jetë.

Gjatë ligjëratës së kësaj nate, Myftiu u lut që dita e Arefatit të jetë një moment kthese në jetën e muslimanëve, një ditë e begatë reflektimi, adhurimi e lutjes, që nxisin në vetvete kuptimin e drejtë të thirrjes: “Lebbejkall-llahumme lebbejke”, edhe përtej kësaj dite dhe këtij adhurimi, që plotëson 1/5 e shtyllave të fesë islame.

KURBAN BAJRAMI, DITË E VËLLAZËRISË DHE BESIMIT

Më 11 gusht 2019, ditën e diel në mëngjes herët, besimtarët muslimanë shkodranë u mbledhën bri xhamisë “Ebu Bekër”, në sheshin e vakëfit të Fushë Çelës, për të falur namazin e Kurban Bajramit, i cili tashmë është bërë traditë të falet në shesh.

Në këtë ditë të gëzuar feste, Myftinia Shkodër organizon një program me ligjërata të larmishme, ku besimtarët e pranishëm, të cilët kanë mbushur sheshin plot, pasi falin së bashku namazin e sabahut, dëgjojnë imamët dhe teologët e Shkodrës.



Ceremonia e festës së Kurban Bajramit filloi me faljen e namazit të sabahut, i cili u drejtua nga teologu Adem Pizga, imam i xhamisë së Perashit dhe pastaj vazhdoi me ligjëratat e mbajtura nga imamët e

nderuar: Adil Cukali - imam i xhamisë së Medresesë, Ruzhdi Plangaj – imam i xhamisë së Kirasit, Durim Kasemi – imam i xhamisë së Parrucës dhe Arben Halluni, përgjegjës i Arsimit pranë Myftinisë.

Përmes ligjërata me vlerë, imamët dhe teologët e nderuar përçuan mesazhe dhe vlera të Islamit. Ata theksuan, se është e nevojshme, që besimtari musliman të zbatojë me korrektësi parimet dhe mësimet fetare islame, që i janë shpallur të Dërguarit të All-llahut, Muhammedi (a.s).

Falja e namazit të Kurban Bajramit u drejtua nga imam i xhamisë “Ebu Bekër”, teologu Idmir Plaku, ndërkohë hytbeja e Kurban Bajramit u mbajt nga imam i tjetër i xhamisë “Ebu Bekër”, teologu Gilman Kazazi.

Pas përfundimit të hytbes, besimtarët e pranishëm uruan njëri-tjetrit festën e Kurban bajramit, duke lutur Zotin (xh.sh) për mirësi e begati, në dynja dhe në ahiret.

PRITJA E VIZITORËVE ME RASTIN E KURBAN BAJRAMIT

Pas përfundimit të ceremonisë së faljes së Kurban Bajramit, ditën e diel, më 11 gusht 2019, siç është bërë traditë për çdo vit, Myftinia Shkodër organizoi pritjen tradicionale të miqve dhe vizitorëve, të cilët vijnë për të uruar festën e begatë të Kurban Bajramit.

Një përfaqësi e përbërë nga imamët dhe këshilltarët të Myftinisë Shkodër, nën drejtimin e teologut Arben Halluni, në mungesë të Myftiut, Imam Muhamed Sytari, për arsye se ndodhej në Haxh, kanë pritur me këtë rast, në xhaminë e Parrucës, miqtë dhe vizitorët, si dhe autoritetet fetare dhe lokale, të cilët erdhën për të uruar këtë ditë të bekuar të festës së sakrificës, Kurban Bajramin.

Kjo traditë e bukur dhe me vlerë e urimit të festave të ndërsjella ndërfaqetare,



nxjerr në pah frymën e harmonisë fetare të Shkodrës, që me të vërtetë është një gjurmë e çmuar e traditës së respektimit të fesë së njëri-tjetrit.

Myftinia Shkodër, ka qenë, është

dhe do të jetë gjithmonë promovuese e vlerave të harmonisë, bashkëjetesës dhe vëllazërisë njerëzore, dhe lutet që Shkodra dhe qytetarët e saj të kenë begatitë dhe mirësitë e Zotit të gjithësisë.

KURBAN BAJRAMI, SI DËSHMI E SOLIDARITETIT

Ditën e dytë të Kurban Bajramit, të hënë, më 12 gusht 2019, Myftinia Shkodër me rastin e festës së begatë të Kurban Bajramit ka shpërndarjen pako të shumta me mish kurban për njerëzit në nevojë dhe personat me aftësi ndryshe, por jo vetëm.

Shpërndarja e pakove me mish kurban, u arrit falë mirësisë dhe bashkëpunimit të institucioneve partnere të ndryshme, veçanërisht Ambasada e Kuvajtit në Tiranë, të cilët kontribuojnë herë pas here me ndihma humanitare për shtresat në nevojë.

Me këtë rast, u ndihmua edhe shoqata e personave me aftësi të kufizuar, ku përfaqësuesi i Myftinisë Shkodër, teologu Arben Halluni pasi i uroi festën e Kurban Bajramit theksoi se institucioni i Myftinisë Shkodër i ka përherë në



vëmendje, sidomos me rastin e festave fetare islame.

Nga ana tjetër, kryetari i shoqatës së invalidëve Para & Tetrapelgjikë, z. Saimir Beqiri shprehu falënderimet e përzemërta

për këtë kontribut të Myftinisë Shkodër, në ndihmë të kësaj shtrese. Ai gjithashtu uroi festën e Kurban Bajramit për gjithë besimtarëve myslimanë, duke u lutur për mbarësi dhe lumturi në familjet e tyre.

HAXHILERËT VIZITUAN DISA VENDE HISTORIKE NË MEDINE



Në kuadër të vizitave që po zhvillojnë në Medinen e Ndriçuar, haxhilerët nga Shkodra u ndalën ditën e shtunë, më 17 gusht 2019, në xhaminë e Kubasë, ku falën edhe dy rekate, sipas traditës së Hz. Muhamedit (a.s.), në zonën e Uhudit, ku shekuj më parë u zhvillua një ndër betejat më të mëdha në jetën e të Dërguarit të All-llahut

(a.s.), si dhe në xhaminë e dy kibleve.

Ata dëgjuan shpjegimet që lidhen me historinë e këtyre dy vendeve dhe mesazhet për realitetet e sotme të botës islame.

Haxhilerët tanë po vijnë qëndrimin në Medine, ku po kryejnë faljet dhe lutjet ditore në xhaminë e Pejgamberit (a.s.).

MBËRRIJNË HAXHILERËT TANË



Ditën e martë, më 20 gusht 2019 mbërritën në Shkodër haxhilerët e këtij viti.

Sipas kontakteve të para, të gjithë haxhilerët janë kthyer shëndosh e mirë, të lumtur për mirësinë e kryerjes së Haxhit të jetës, si dhe të mbushur me emocione nga vizita e vendeve të shenjta dhe xhamia e Resulull-llahut (a.s.).

All-llahun e Madhëruar e lusim, që t'ua ketë pranuar Haxhin e tyre dhe krejt adhurimet e tjera. - HAXH MABRUR!



Paraditën e së hënës, më 26 gusht 2019, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, zhvilloi një inspektim për të parë nga afër punimet për qendrën e re islame të zonës së Shirqit.

Xhamia dhe klasat e saj, janë një projekt që po zbatohet falë bashkëpunimit të Myftinisë Shkodër me Fondacionin "Mirësia", me fonde bamirëse nga Shteti i Kuvajtit.

Gjatë inspektimit të sotëm, Myftiu dha edhe një video-mesazh, nëpërmjet të cilit shprehu kënaqësinë e tij për këtë realitet të ri, që gëzon krejt besimtarët e kësaj zone dhe përtej saj.

Ndër të tjera, Myftiu tha: "Zhurma e punës dhe angazhimi i punëtorëve për të përfunduar xhaminë e re, më sjell ndër mend momentin kur Pejgamberi i jonë (a.s.) erdhi në Medine dhe, puna e parë që bëri kur mbërriti në atë qytet të bekuar ishte ndërtimi i xhamisë... Sa shkojmë në Kuba dhe e falem ty, e

VAZHDOJNË PUNIMET PËR XHAMINË E RE NË SHIRQ



ndiejmë preken e duarve të Pejgamberit (a.s.) në çdo vend... I lutemi All-llahut të Madhëruar të begatojë kontributin e atyre që punojnë për lartësimin e fesë së All-llahut!"

Myftiu shprehu falënderimet e tij edhe për të nderuarin, z. Korab Kaja, drejtor i Fondacionit "Mirësia" për këtë kontribut të madh në rrugën e ngritjes së xhamisë së re në Shirq.

REAGIMI I MYFTINISË SHKODËR RRETH VAKËFIT TË ZAPTUAR NË ZDRALEJ

Në adresë të Myftinisë Shkodër, ditën e mërkurë, më 28 gusht 2019, ka mbërritur një kërkesë nga kryeredaktori i gazetës "Koha e Jonë", z. Qamil Khani, për të dhënë një reagim në lidhje me akuzat e paqena, me

myftinie kërcënimi me jetë i askujt, as grabitja e pronës private. Të dyja këto, jeta dhe prona (por jo vetëm), janë të shenjta për ne në Islam dhe, drejt kësaj thërrasim vazhdimisht në predikimet tona tradicionale.



Ne nuk zaptojmë pronën e huaj, as abuzojmë me shenjtëritë e tjetrit. Ky është kufi i kuq, fetarisht dhe ligjërish!

Por, njëkohësisht, aty ku kemi vendime gjyqate për të drejtën tonë, a urdhra ekzekutimi të parealizuar nga institucionet vendore, a të ngjashme, natyrshëm që do të ndjekim rrugët ligjore të vendit tonë për të arritur tek e drejta e jonë e shenjtë, pa toleruar asnjë përpjekje për rigrabitjen dhe rizhvatjen e pronës tonë legjitime!

Vakëfet janë të shenjta dhe kthimi i tyre në origjinë është borxh moral e shpirtëror, qytetar e kombëtar, në hak të atyre që nuk janë më dhe të atyre që do të vijnë!

Bekime e mirësi paçi!

Imam Muhamed B. Sytari

Myfti i Zonës Shkodër
Shkodër, më 28 gusht 2019

P.S.

Ju sjellim në vëmendje se çështja e zaptimit të këtij vakëfi është bërë publike prej shumë vitesh nga Myftinia Shkodër, sikurse nuk do të heshtet as tolerohet asnjë rast zaptimi, sado i vogël qoftë, përtej vullneteve politike dhe përkrahjes së zullumit në vendin tonë!

<http://msh.myftinia-shkoder.org/old-myftinia-shkoder.org/195.html>

të cilat zaptuesit e një pjese të vakëfit në Zdralej, përbaltin Myftininë e Shkodrës.

Për këto akuza dhe trillime, po përgatitet një padi në drejtim të personave në fjalë, ndërsa më poshtë, reagimi i Myftinisë Shkodër:

Përsëritet z. Qamil. Ju uroi mbarësi e shëndet.

Natyrshëm, nuk hyn në misionin e Myftinisë Shkodër dhe të asnjë

Nga ana tjetër, janë mbi 100 dosje me pronat e grabitura, të tjetërsuara e të zhvatura qysh pas vitit 1967 dhe të patrajtuara me seriozitetin e duhur në AKKP.

Për këtë, si Myftinia Shkodër, ashtu edhe Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, është i angazhuar me krejt rrugët legjitime për të arritur më të mirën në drejtim të kthimit të pronave të zaptuara.

Paraditën e së enjtes, më 29 gusht 2019, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, zhvilloi një inspektim për të parë nga afër punimet që po kryhen për xhaminë e madhe në lagjen Kiras.

Pasi pa nga afër nivelin e punimeve dhe se si objekti i ri shumëfunksional po merr formë dita-ditës, Myftiu dha edhe një mesazh, nëpërmjet të cilit shprehu falënderimet për Fondacionin “Mirënjohja” dhe drejtuesin e saj, z. Samed Shehu, si dhe donatorin nga Shteti i Kuvajtit, për këtë mirësi të madhe për Shkodrën.

Myftiu bëri thirrje që personat që kanë uzurpuar vakëfet e Shkodrës, ta kenë frikë Zotin dhe të kthehen nga udhëzimi i Tij, duke hequr dorë nga kjo padrejtësi e madhe, me të cilën kanë rënduar veten, duke u bërë grabitës të vakëfit të shenjtë.

Ai tha se prona është e shenjtë dhe se i takon pronarit legjitim, sidomos kur fjala është për pronat e Myftinisë Shkodër, një pjesë e mirë e vakëfeve të së cilës ngelen

VIJOJNË PUNIMET PËR XHAMINË E MADHE TË KIRASIT



të shkelura nga mungesa e drejtësisë dhe institucioneve të përgjegjshme, si dhe nga dobësia e besimit në zemrat e njerëzve, që është edhe faktori kryesor.

Myftiu tha se qeveria duhet ta ketë prioritet kthimin e pronës tek i zoti, jo të nëpërkëmbë pronarët legjitimë, veçanërisht komunitetet fetare.

MBRËMJE FETARE NË PËRKUJTIM TË VITIT TË RI HIXHRI 1441

Ditën e enjte, më 29 gusht 2019, pas namazit të akshamit në xhaminë e “Dy Vajzave”, Myftinia Shkodër organizoi aktivitetin me temë “Hixhreti – në gjurmët e një historie, që rrezaton shpresë...”, në përkujtim të vitit të ri Hixhri 1441.

Aktivitetin e hapi imami i xhamisë teologu Lavdrim Hamja, i cili uroi të pranishmit me rastin e këtij viti të ri 1441.

Imami i nderuar theksoi se tubimet që lidhen me përkujtimin e datave të shënuara islame janë një mundësi për të risjellë në vëmendjen e besimtarëve mesazhet që na dhurojnë këto ngjarje.

Aktiviteti u pasua nga ligjërata e Myftiut të Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i cili u ndal tek mesazhi kryesor i kësaj ngjarjeje të madhe në jetën e Resulull-llahut (a.s.), sikurse bëri lidhjet e saj me realitetet e muslimanëve në Shqipëri, politikën islamofobe, si dhe realitetet e muslimanëve kudo në botë.

Ai u shpreh se përkujtimi i Hixhretit, ndër të tjera na sjell në vëmendje një mesim shumë me vlerë, fjalën e të Dërguarit të All-llahut (a.s.), që i tha shokut të tij të vetëm gjatë Hixhretit, Ebu Bekrit (r.a): “Mos u dëshpëro, All-llahu është me ne!”.

Kjo fjalë shumë domethënëse duhet



t'i shërbejë si shpresë secilit prej nesh në rrugëtimet e tij në jetën e kësaj bote.

Më pas e mori fjalën teologu Lavdrim Hamja, i cili u ndal tek mësimet e Hixhretit, si ngjarje me shumë vlerë për muslimanët në çdo kohë. Ai theksoi, se Hixhreti na mëson se duhet të rendin pas sebepeve dhe shkaqeve, të jemi të vendosur dhe të mbështetemi tek All-llahu, të zgjedhim shokët e jetës, të jemi të durueshëm dhe të përkushtuar, në mënyrë që Zoti të na ndihmojë dhe të jetë Mbrotjtësi ynë.

Për të ligjëruar në këtë mbrëmje ishte edhe teologu Agim Elezi, ku gjatë bisedës së tij u ndal tek roli dhe shembulli i

përkryerit i Pejgamberit (a.s.), si frymëzim për ne deri në ditën e fundit.

Njëkohësisht shprehu falënderim për brezin e të moshuarve, që e ruajtën fenën dhe tashmë mbeten fenerë ndriçues për brezin e ri.

Ai, ndër të tjera tha, se çdo musliman duhet ta pasojë të Dërguarin e All-llahut në sjelljet dhe moralin e tij dhe se sfiat e jetës, nuk duhet ta ndalin nga rrugëtimi i tij drejt Krijuesit të gjithësisë.

Në fund të aktivitetit u shpërndanë disa libra me tematika të ndryshme, si dhe Kur'ani Famëllartë në gjuhën arabe.

Për të pranishmit u shtrua edhe një koktejl.

U MBLODH KËSHILLI I RI I MYFTINISË SHKODËR



Nën drejtimin e Myftiut të Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, ditën e xhuma, më 30 gusht 2019, u zhvillua mbledhja e parë e Këshillit të ri të Myftinisë Shkodër.

Në fjalën e tij, Myftiu falënderoi imamët dhe përfaqësuesit e xhamive për zgjedhjen e antarëve të Këshillit të ri të Myftinisë Shkodër për periudhën 2019-2023, sikurse uroi këshilltarët e pranishëm për mbarësi dhe sukses me rastin e përzgjedhjes së tyre si pjesë e

këshillit të ri të Myftinisë Shkodër.

Myftiu tha se sfidat e Myftinisë Shkodër janë të shumta dhe se përgjegjësitë janë të mëdha. Ai theksoi se dita-ditës po shfaqen dukuri dhe fenomene që prekin tabanin fetar e kombëtar të shoqërisë shqiptare, që do të thotë se angazhimi i institucioneve fetare, këshilltarëve, imamëve e thirrësve islamë duhet të jetë maksimal dhe pa asnjë kursim.

ANDALUZIA, “NJË MIJË E NJË NETË” POR, JO PËRRALLË

Andaluzia është krahina më jugore dhe më e ngrohtë e Spanjës, pjesë e gadishullit Iberik, ku për tetë shekuj muslimanët kanë lënë gjurmët e tyre në kulturë, arkitekturë, mënyrë të jetës, por edhe mbi gjuhën e cila dallon nga gjuha standarde spanjolle, për çka ndryshe quhet edhe të folurit andaluzian.

Granada, Sevilla dhe Mallaga janë qytetet andaluziane të cilat kanë qenë shtëpi e artistëve të njohur, siç janë Pablo Picasso dhe Ernest Hemingway i cili madje shkroi për Andaluzinë në romanin e tij “Dhe lind dielli”.


Simbol i bashkimit të Spanjës llogaritet Granada, ndërsa njëri nga simbolet e këtij qyteti andaluzian padyshim se është Alhambra ose Pallati

i Kuq. Bëhet fjalë për kompleksin e mrekullueshëm romantik me monumente të kulturës islame, që e bën të jetë njëri nga atraksionet kryesore turistike në Spanjë.

Ndërtuar në shekullin e 13-të, Alhambra u ngjan pallateve të përshkruara në “Një mijë e një netë”, koleksionin e famshëm të tregimeve të shkurtra të letërsisë arabe dhe persiane.

Një nga monumentet më të rëndësishme të kulturës islame në Andaluzi, padyshim se është xhamia e Madhe e Abd al-Rahmanit në Cordoba, e cila u ndërtua në shekullin e VIII, dhe bashkë me Alhambran ndodhen në listën e UNESCO-s të monumenteve që janë trashëgimi botërore.

(www.tesheshi.com)



DOBI E SHTRENJTË, QË MERITON TË UDHËTOHET DREJT SAJ!

(Rreth vdekjes së Halid ibnul-Velidit në shtrat dhe jo në luftë)

Shejkh Abdulfetah Ebu Guddes tregon, se një herë ka udhëtuar drejt Indisë për të takuar kolosin indian, hadithologun e madh, memorizuesin e mençur, Jakub En-Nanuti.

Shejkh Jakubi i thotë shejkh Abdulfetahut: A, e di urtësinë e vdekjes së Halid ibnul-Velidit (r.a) në shtratin e ti, me gjithë sinqeritetin që ka pasur në kërkim të rënies dëshmorë (marterizimit) në rrugën e Allahut, në beteja dhe situata të ndryshme dhe nën hijen e shpatave, në më shumë se 120 beteja të ashpra?!

Shejkh Abdulfetahu i thotë: Jo!

Shejkh Jakubi: Dijetarët tanë na kanë treguar se Pejgamberi (a.s) e ka quajtur Halidin “Shpata e mprehtë e Allahut”, e nëse ai do të vritej në ndonjë betejë, atëherë kjo do të nënkuptonte, se shpata e Allahut është thyer, por shpata e Allahut nuk thyhet kurrë asnjëherë, në mënyrë, që njerëzit të mos thonë: U vra shpata e Allahut dhe u thye! Por, Allahu ka zgjedhur për të, të vdesë në shtratin e tij.

Shejkh Abdulfetahu tha: Pasha Allahun, kjo dobi është më se e mjaftueshme, që të udhëtohet drejt saj për në vendet e Indisë, dhe sikur të mos kisha përfutur, vetëm se këtë gjë në udhëtimin tim, kjo do të më kishte mjaftuar!

(Jeta e Abdulfetah Ebu Guddes)



MYFTINIA SHKODËR JU URON:
MUBAREK VITIN E RI HIXHRI 1441
31 GUSHT 2019 - 1 MUHARREM 1441

Pejgamberi (a.s) ka thënë:

**“Mos bëni padrejtësi,
SEPSE PADREJTËSIA ËSHTË ERRËSIRË
në Ditën e Kiametit!”**

[Transmetuar nga Muslimi]



Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

 
MYFTINIA SHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org